



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
Sektori i Sekretari-Arkivit

Model nr.5

KARTELE SHOQERUESE E PRAKTIKES

Dergues Prezekti i Arkivit
06.02.2020

Nr. Prot. 114/ Data

Shkurtimi i lendes Kshim pagellete per liqshmerine e V.k.B.

Per trajtim nga:	
(struktura te tjera te ngarkuara)	<u>Shk. d. d. k. b. bashkis</u>
Me porosi:	<u>Zi Enxha Jiselo</u>

Afati: Normal 7dite) Prioritet:3dite) Urgjent:(brenda dites) Pa afat/per dijeni) Tjeter) _____ dite

Data 10.02.20 Nr. Prot. 530/1

Nenshkrimi: (TITULLARI)

Nenshkrimi

Marre ne dorezim: _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Meporosine: -----

Marre ne dorezim: _____

Nenshkrimi _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Meporosine: -----

Marre ne dorezim: _____

Nenshkrimi _____

Kalon per trajtim Specialistit: _____

Me porosine: -----

Trajtimi i materialit perfunduar me: _____

Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Eprori ne shkalle hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 114/1 Prot.

Fier, më 06.02.2020

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda **BUFI**
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri **HYSKA**
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 530 prot. datë 29.01.2020, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 114 prot. datë 30.01.2020, bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 16, shqyrtoam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 24.01.2020 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 01 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Mbi miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 49 pika 1,2, 3 dhe neni 54 gërma “j”.

Vendimi Nr. 02 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6 % për periudhën 1- 31 Dhjetor 2019” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën



ekonomike” Kreu i IV pika 2 dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

Vendimi Nr. 03 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmën ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6 % për bllok- ndihmën për vitin 2020” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Kreu i IV pika 2 dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

Vendimi Nr. 04 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një ndryshim në VKB Nr. 116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjeve vartëse si dhe niveli maksimal i pagave për vitin 2020” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 gërma “dh” Ligjin 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” dhe Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Vendimi Nr. 05 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për ndryshim të buxhetit 2020 nga zbatimi i projektit: “Forcimi i mekanizmit të kordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Roskovec”Me financim të UNDP- së” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 24 pika 1 dhe neni 54 gërma “dh”, Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 20 pika 1, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Ligjit Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”(i ndryshuar) neni 5 gërma “ë” dhe në zbatim udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit”

Vendimi Nr. 06 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një ndryshim në vendimin Nr. 105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2020” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 27 pika 1 dhe neni 54 gërma “f”, Ligjin Nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” neni 18 dhe neni 19 dhe në



zbatim Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) neni 35 pika 2.

Vendimi Nr. 07 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e listës së inventarit të pronave pyje/kullota që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 27 pika 5 dhe neni 54 gërma “k”, Ligjin Nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit (i ndryshuar) neni 6 pika 2 gërma “b”, Ligjin Nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 111/2018 “Për kadastrën” dhe në zbatim VKM Nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive.

Për vendimin Nr. 08 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një shtesë të listës së inventarit, miratuar me VKM Nr. 1210 datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kuman, të Qarkut të Fierit” Konstatojmë se ka një mospërputhje të sipërfaqes të pasurisë Nr. 41/1 të cilën kërkoni ta shtoni në inventarin e pronave në vendim me sipërfaqen e kësaj pasurie që është konfirmuar nga Agjencia Shetërore e Kadastërs, Drejtoria Vendore Fier. Konkretisht në vendimmarrje keni miratuar pasurinë me Nr.41/1 me sipërfaqe 428 m² (truall dhe ndërtesë) ndërsa me shkresën Nr. 710/1 Prot datë 29.01.2020 ASHK-ja Drejtoria Vendore Fier konfirmon se pasuria me Nr.41/1 ka sipërfaqe 150 m² nga ku 150 m² truall dhe 150 m² ndërtesë. Për sa më sipër ky vendim ju kthehet për rishqyrtim.

Ekzekutivi i Bashkisë Roskovec duhet të jetë më i kujdesshëm në përgatitjen e materialeve për në këshill pasi shpesh janë konstatuar pasaktësi nga ana jonë.

Për Vendimin Nr. 09 datë 24.01.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një ndryshim në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr. 770 datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit” do të shprehemi pasi të njihemi me:

- Dokumentacionin që provon kalimin e sipërfaqes prej 2000 m² në pronësi të Kishës Ortodokse shoqëruar me planvendosjen përkatëse dhe konfirmimin nga ASHK-ja.



- Kërkesën e ASHK- së që Bashkia Roskovec të heq nga inventari i saj sipërfaqet prej 145 m2 për objektin në proces legalizimi të Z. Shpëtim Isufaj dhe 185 m2 për objektin e Z. Ismail Isufaj.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec për heqjen nga inventari të këtyre dy këto sipërfaqeve shoqëruar me planvendosjen përkatëse.
- Konfirmim nga ASHK- ja dhe planvendosjen për sipërfaqen prej 100m2 ambient shërbimi.
- Konfirmim nga ASHK-ja për sipërfaqen e pronës aktualisht.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Baki BALA



Në mungesë dhe me urdhër
KOORDINATORI I PËRGJITHSHËM
ARBEN VELO